

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Nr. 9658 Prot.

Tiranë, më: 05.11.2019

Lënda: Kërkesë për bashkëpunim

Drejtuar: BASHKISË DROPULL

I nderuar z/znj. Kryetar

Në zbatim të ligjit nr.93/2015 “Për Turizmin”, i ndryshuar, pikës 3 të Nenit 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar si dhe Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.267, datë 24.07.2019, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar, ka filluar procesi për kategorizimin e Strukturave Akomoduese.

Ky proces ka si qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve në strukturat akomoduese, reduktimin e informalitetit, krijimin e bazës së të dhënave të strukturave akomoduese dhe kapaciteteve të tyre.


Legjislacioni i turizmit, konkretisht pika 3 e nënit 4 të VKM nr. 730/2016, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Cdo sipërmarrës turistik që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, për përfitimin e lehtësirave fiskale sipas legjislacionit në fuqi, duhet t’i nënshtrohet procesit të kategorizimit të strukturave akomoduese.

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 267, datë 24.07.2019, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar, afati kohor I aplikimit është deri në datën 31.12.2019. nëse subjekti nuk ka aplikuar brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e cituar më sipër, përfitimi i TVSH-së së reduktuar do të ndërpritet.

Sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj për sensibilizimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si strukturë akomoduese Brenda juridiksionit administrative që mbulon Bashkia Juaj, mbi këtë proces.

Informacionin e plotë në lidhje me procesin e kategorizimit mund ta gjeni në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit: www.turizmi.gov.al, në menu-në Turizmi/Udhëzues për Qytetarët.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



MINISTËR
BLENDI KLOSI